



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL A nr. 6/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lista Sërbe dega Mitrovica e Veriut, paraqitur kundër Dragan Jabllanoviçit kryetar i komunës së Leposaviçit, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale duke e shfrytëzuar pozitën publike, në seancën e panelit të mbajtur me 05.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL Anr. 6/2017 e datës 31.08.2017 e subjektit politik Lista Sërbe dega në Mitrovica e Veriut.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 31.08.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lista Sërbe dega Mitrovica e Veriut, me të cilin thekson se kandidati për kryetar të komunës dhe kryetari aktual i komunës së Leposaviçit Dragan Jabllanoviç me datën 28 gusht 2017 nëpërmjet facebookut zyrtar të subjektit të tij politik Partija Kosovski Srba ka publikuar ftesën e komunës së Leposaviçit për ndarjen e materialit ndërtimor për qytetarët e komunës së Leposaviçit, veprime këto të cilat sipas palës ankuese janë në kundërshtim me nenin 35.1 të Ligjit për zgjedhje përgjithshme.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografimin me pamje nga faqja zyrtare të facebookut të subjektit politik PKS për të cilat pretendohet në ankesë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

ankesa është e palejuar

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe*

Kandidatët dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për fillimin e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet Lokale 2017 fillon nga data 21.09.2017 dhe zgjat deri më datën 20.10.2017, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL A nr. 6/2017 më datën 05.09.2017.



Këshilla Juridike: Kundur këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.